



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 016-21633/22

Klinë, datë 24.06.2022

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun me lokalitetet: Drenoc, Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm dhe Dugajevë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "Isa Boletini", në fshatin Drenoc. Tubimi u mbajt me datë 22 qershor 2022 dhe filloi në orën 18:00, ku morën pjesë: 31 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e paraqiti ushtruesi i detyrës së drejtorit të drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Ajet Sejdiu, i cili paraqiti buxhetin për vitin 2023 dhe projektet e planifikuara.

Pas z. Sejdiu, fjalën e mori edhe kryetari Elezaj, ku para banorëve të këtyre lokaliteteve, theksoi projektet investive që pritet të realizohen e që janë rrugicat, kanalizimet, asfaltimi, ura e fshatit Dugajeve që është një ndër projektet me të rëndësishme, dhe po punohet në realizimin e saj.

DISKUTIMET

1. **Halil AVDIU**- si banorë kemi shume kërkesa, si ujin e pijes, pastaj shtyllat elektrike që rrezikojnë të rrezohen, se treti një rrugë të shtrohet me zhavorr tek

varrezat, disa rrugica, shtrati i lumit është i paqëndrueshëm, dhe kanalizimi është i dobët sidomos tek lagjja e Fejzave dhe Ademaj.

2. **Naser Zekolli-Drenoc**- 5 anëtarë të familjes, nuk kemi ujë të pijes, jam i varfër me social, i papunë, si pasojë kam ndaluar shkollimin e djalit në studime të larta, rruga e shtëpisë është në gjendje të keqe, as mbeturinat s'mund ti marrin. Kam një fëmijë me aftësi të kufizuara dhe kam nevojë për përkrahje nga komuna dhe institucionet. Ndërsa toka është gërryer nga lumi dhe zalli është pengesë për të punuar token bujqësore.
3. **Shaqir Fejza**- Drenoc. Kam kërkuar transportin e nxënësve për shkak të rrezikut të magjistrales dhe shpejtësisë së lartë të makinave. Kërkoj të sigurohet transporti i nxënësve për shkak se nuk kemi as trotuar. Po ashtu ndriçimi publik.
4. **Gjilan Rama**- Ka rrugë për tu shtruar, por nuk mund të shtruhet për shkak se janë dyert e oborrit, dhe nuk mund ta shpronësoj.
5. **Faton Gojani**- I përfshitë pothuajse të gjitha nevojat tona. Por kemi një kërkesë për tokat tona që të ndërtoni kanale të ujitjes së tokave, për shkak të thatësisë. Sepse këto projekte janë të fokusuar vetëm nga Budisalci dhe fshatrat tjera.
6. **Avni Avdyli**- Shtrati i lumit nuk është kryer, por është premtuar. Të korrat dëmtohen nga uji që vërshon për shkak të mos rregullimit të shtratit.
7. **Bedri Rama**- kam investuar në një stallë të lopëve, kam investuar në rrugë por kam nevojë që të më shtruhet me asfalt pasi që bazën e kam të shtruar me zhavorr, pasi që kam bërë investime të konsiderueshme dhe mjetet e rënde të punës po e dëmtojnë këto rrugë.

Takimi përfundoi në orën 19:40.

Procesmbajtësi



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'KOMUNA E KLINES MUNICIPALITY OF KLINE' around the inner border, and 'KLINË' in the center. There is also a small emblem in the center of the stamp.